



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d), nenit 40.2 shkronja j) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 6 paragrafët 2.1 dhe 6 të Ligjit për bashkëpunim ndër-komunal nr.04/L-010, dhe neneve 14 dhe 15 paragrafi 2.4, nenin 34 paragrafi 2.10 të të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/19, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 mars 2024, miratoi këtë,

### **V E N D I M**

#### **PËR MIRATIMIN E NISMËS PËR THEMELIMIN E BASHKËPUNIMIT NDËR - KOMUNAL**

##### **Neni 1**

Me këtë vendim miratohet Nisma e Kryetarit të Komunës për themelimin e bashkëpunimit ndër - komunal mes Komunave;

- Komuna e Vushtrrisë
- Komuna e Prishtinës
- Komuna e Podujevës
- Komuna e Mitrovicës së Jugut
- Komuna e Obiliqit

##### **Neni 2**

Qëllimi i themelimit të bashkëpunimit ndër-komunal sipas këtij vendimi është fillimi i studimit të fizibilitetit dhe hartimi i projektit të përbashkët me participim të 5 komunave, për ndërtimin e rrugës Barilevë – Kozaricë - Dumnicë e Epërme – Kunovik – Vesekoc – Kurillovë - Bajgorë, projekt ky i cili do të procedohet për financim nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës nga viti 2025, projekt ky i cili është me karakter regional dhe i një rëndësie të veçantë për interesin e përgjithshëm publik për Komunitat përkatëse dhe jo vetëm, me theks për zhvillimin ekonomik dhe agroturizmin.

##### **Neni 3**

Bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëjta reciprociteti dhe përfitimit të shumanshëm në mbrojtje dhe zhvillim të interesit të përgjithshëm publik.

##### **Neni 4**

Kryetar i Komunës së Podujevës, me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës do të autorizohet për fillimin e konsultimeve me Komunitat e cekura dhe përgatitjen e propozim Marrëveshjes për bashkëpunim të ndërsjellë.

##### **Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-016/01-0020890/24  
Podujevë, datë: 29 mars 2024

